

komuna e Shtimes/Štimlje, murator, pesë fëmijë)

Vëllezërit Vehbiu dhe Fehmiu me familje kanë jetuar në Carralevë/Crnoljevo. Në datën **13.06.1998**, Vehbiu u nis me traktor për në Shtime/Štimlje për tu furnizuar me karburante. Nuk u kthye kurrë më. Ditën tjetër [**14.06.1998**], Fehmiu, së bashku me disa familjarë, u nis për në fshatin fqinj të Pjetërshiticës/Petraštica [Shtime/Štimlje], për të mësuar për fatin e të vëllait. As ai nuk u kthye më në shtëpi kurrë. Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi, në lëndën e Fatmir Limajt dhe të tjerëve, ka konstatuar se Fehmi Xhema ka qenë i burgosur në kampin e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**, nga data 13 qershor deri në ditën e pacaktuar, e cila i ka paraprirë datës 25 apo 26.07.1998. E kishin keqtrajtuar mizorisht.

Mbetjet mortore të vëllezërve Tafa u gjetën në varrezat e Mirenes/Mirena [Lipjan/Lipljan], në muajin shtator të vitit 2003. Në procesverbalin mbi obduksionin e kufomës së tij, që u krye më 13.10.2003, është konstatuar se vdekja Fehmiut ka rezultuar nga plaga në gjoks, e shkaktuar me armë zjarri. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Fehmiut në varrezat e Carralevës/Crnoljevo më 11.02.2005. Mbetjet mortore të Vehbiut i janë dorëzuar familjes më 28.07.2006. Po atë ditë, ai është varrosur në varrezat e Carralevës/Crnoljevo.

Burimet: deklarata H.X, FDH-11626; deklarata M.T, FDH-26770; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [## **Slobodan \(Blagoje\) Mitrović**](http://www.hlc-rcd.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(IT-03-66-); KNKK, <i>Persona të zhdukur...</i>, FDH-9795; OMPF, <i>Mbetjet...</i>, FDH-15297; FDH, <i>Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz</i>, pyetësor, FDH-27001.</p></div><div data-bbox=)

(26.02.1958, serb nga Suhareka/Suva Reka, komuna e Suharekës/Suva Reka, tregtar, dy fëmijë)

Miodrag (Atanasije) Krstić

(10.09.1964, serb nga Reçani/Rečane, komuna

e Suharekës/Suva Reka, katër fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Milovan (Atanasije) Krstić

(10.10.1969, serb nga Reçani/Rečane, komuna e Suharekës/Suva Reka, dy fëmijë, inxhinier i makinerisë)

Vëllezërit Miodragu dhe Milovani, si dhe djali i hallës Slobodani, jetonin në fshatin Reçan/Rečan në afërsi të Suharekës/Suva Reka. Miodragu ishte inspektor policie. Punonte në Shërbimin e Punëve të Brendshme të Suharekës/Suva Reka. E braktisi punën më 6.06.1998, nga revolti që nuk ia ndanë banesën. Milovani ishte punësuar në ndërmarrjen *Balkan*. Slobodani e kishte ndërmarrjen e vet private *Grand komerc*, si dhe televizionin privat dhe auto-shkollën. Merrej edhe me biznese tjera. Nga mesi i muajit qershor, bashkëshortja e Slobodanit Ljiljana me fëmijë kaluan te prindërit e saj në Arangjellovac [Serbi] për shkaqe sigurie. Slobodani ka mbetur në Kosovë. Nga data 16.06.1998, Milovani gjendej për shërim në Qendrën Klinike në Beograd, për shkak të tensionin të lartë të gjakut. Në datën 23.06.1998, Miodragu dhe Slobodani u nisën për Beograd për ta marrë Milovani, i cili u lëshua nga spitali. Rugës për në Beograd, Slobodani u ndal në Arangjellovac për vizitë te Ljiljana dhe fëmijët. Një ditë më vonë, më **24.06.1998**, Miodragu dhe Milovani, në rrugën e tyre prej Beogradit për në Kosovë, e morën Slobodanin në Arangjellovac. Pastaj, që të tre u nisën për në Reçan/Rečane. Udhëtonin me veturën e Milovanit të tipit *Golf 3* të ngjyrës teget-blu. Diku nga ora 11:30, ata e thirrën me telefon nga Krushevcu motrën në Barajevë. I thanë se ishin duke pushuar dhe se së shpejti do ta vazhdonin rrugën për të arritur në shtëpi para se të bie terri i natës. Të postblloku i Shtimjes/Štimlje, policia i ka ndalur dhe u ka tërhequr vërejtjen se rruga më tutje ishte e bllokuar nga pjesëtarët e UÇK-së. Por, ata vendosën të vazhdonin rrugën. Një ditë më vonë, Ljiljana ka mësuar nga një shqiptar i Suharekës/Suva Reka se UÇK-ja i kishte rrëmbyer Slobodanin, Milovani dhe Miodragun në Carralevë/Crnoljevo, dhe se i ka çuar në drejtim